



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KUVENDI

**PROJEKTLIGJ**

Nr. \_\_\_\_/2017

**PËR**

**DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 9616, DATË 27.9.2006 "PËR LIBRIN  
NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË"**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**V E N D O S I:**

Ne ligjin nr. 9616, date 27.09.2006 "*Për librin në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar bëhen shtesat dhe ndryshimet, si më poshtë vijon:

**Neni 1**

Në nenin 2 pas paragrafit të dytë, shtohet paragrafi i tretë dhe i katërt me përmbajtje si më poshtë:

*“Në këtë ligj përcaktohen rregullat e organizimit, të funksionimit, realizimit dhe financimit të projekteve dhe programeve të librit, si dhe të drejtat e detyrimet e subjekteve që kanë për objekt veprimtarie librin dhe produkte të përafërta me librin.*

*Ligji, krijon kushtet për botimin e librave të autorëve në fushën e letërsisë dhe shkencave shoqërore, përkthime të autorëve shqiptarë në gjuhë të huaj dhe anasjelltas, bashkëpunimin ndërkombëtar në fushën e librit, festivaleve, panairove dhe ngjarjeve letrare, zhvillimin e rrjetit libror, zhvillimin e kulturës së leximit, promovimin e librit, autorëve dhe leximin, koordinimin e*

*të gjitha lidhjeve në zinxhirin e politikave të librit, trajnimin shtesë profesional dhe të specializuar në fushën e librit, të drejtën e huadhënies publike sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për të drejtën e autorit dhe digjitalizimin në fushën e librave.”.*

## **Neni 2**

Në nenin 3 bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

1. Në pikën 5 togëfjalëshi “...106 të ligjit nr.9380, datë 28.4.2005 “Për të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të.” zëvendësohen me togëfjalëshin “...127 të ligjit nr.35/2016, datë 31.03.2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to.”.

2. Pas pikës 11 shtohet pika 12 me përmbajtje si më poshtë:

12. “Bazë të dhënash” është titulli ose emri personal i propozuesit të një programi ose projekti, adresa e vendbanimit ose zyra e regjistruar e propozuesit, objekti dhe fushëveprimi i projektit ose programit të bashkëfinancuar, shuma e financimit të projektit apo programit, rezultatet e financimit, emrin personal dhe adresa e vendbanimit të përhershëm të përfituesit të projektit, si edhe elemente të tjerë të nevojshëm në punën e Qendrës Kombëtare të Librit dhe Leximit.”

## **Neni 3**

Titulli i emërimit të Kreut III “**KËSHILLI KOMBËTAR I LIBRIT DHE I NXITJES SË LEXIMIT**” zëvendësohet me togëfjalëshin “**ORGANET KËSHILLIMORE DHE INSTITUCIONET NË FUSHËN E LIBRIT**”.

## **Neni 4**

Në nenin 8 bëhen shtesat dhe ndryshimet si më poshtë:

1. Shtohet titulli i nenit me këtë përmbajtje: “*Këshilli Kombëtar i Librit dhe i Nxitjes së Leximit*”

## **Neni 5**

Neni 10 ndryshohet si më poshtë:

### **“Neni 10**

#### ***Përbërja e Këshillit Kombëtar të Librit dhe i Nxitjes së Leximit***

1. *Këshilli Kombëtar i Librit dhe i Nxitjes së Leximit kryesohet nga Ministri përgjegjës për librin.*

2. Anëtarët e KKLNL-së janë:

- a) Kryetari i Akademisë së Shkencave të Republikës së Shqipërisë.
- b) Drejtori i Bibliotekës Kombëtare.
- c) Kryetarët e shoqatave të botuesve shqiptarë.
- ç) Përgjegjësi i Departamentit të Letërsisë në Universitetin e Tiranës.
- d) Përfaqësuesi i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.
- dh) 2 (dy) anëtarë të tjerë, personalitete të njohura të fushës, që caktohen nga Ministri përgjegjës për librin, për një periudhë 4-vjeçare.

3. Në mbledhjen e KKLNL-së ftohen të marrin pjesë drejtues të Ministrisë përgjegjëse për librin, përgjegjës për çështjet e librit dhe me kërkesë të Ministrit, edhe përfaqësues të ministrive dhe institucioneve qendrore, në varësi të çështjeve objekt diskutimi.”.

## **Neni 6**

Në nenin 11 ndryshohet si më poshtë:

### **“Neni 11 Mënyra e funksionimit të KKLNL-së**

1. “Mënyra e funksionimit dhe organizmit të KKLNL-së përcaktohet me Urdhër të Ministrit përgjegjës për librin.
2. “Qendra Kombëtare e Librit dhe Leximit shërben si sekretari tekniko-administrative në mbledhjet e KKLNL-së”.”

## **Neni 7**

Pas nenit 11 shtohen nenet 11/1, 11/2, 11/3, 11/4, 11/5 dhe 11/6 si më poshtë:

### **“Neni 11/1 Qendrës Kombëtare të Librit dhe Leximit**

1. Qendra Kombëtare e Librit dhe Leximit (QKLL) krijohet dhe funksionon si person juridik, publik, me statusin e institucionit qendror, në varësi të Ministrisë përgjegjëse për librin.
2. Qëllimi i QKLL është përmbushja e detyrave profesionale, zhvillimore dhe ekzekutive që lidhen me zbatimin e dokumenteve strategjike dhe politikave në fushën e librit. QKLL kryen çdo funksion që lidhen me promovimin, nxitjen dhe zhvillimin e politikave në fushën e librit. QKLL siguron kushtet për rritjen e ndërgjegjësimit për rëndësinë e librit dhe leximit në zhvillimin e individit dhe shoqërisë, brenda dhe jashtë vendit.

3. QKLL kryen funksionet e parashikuara në këtë ligj në interes të publikut, me qëllim krijimin e kushteve për zhvillimin e fushës së librit dhe marrjen e vendimeve profesionale, cilësore dhe të pavarura në përzgjedhjen e programeve dhe projekteve të financuara nga buxheti shtetit.

4. Statuti i QKLL miratohet me Urdhër të Ministri përgjegjës për librin, me propozim të Drejtorit të QKLL. Struktura dhe organika e QKLL miratohet me Urdhër të Kryeministrit.

5. Ligji nr. 10 352, datë 18.11.2010 “Për Artin dhe Kulturën”, i ndyshuar nuk zbatohet për çështjet që rregullohen nga ky ligj.

### **Neni 11/2** **Detyrat e QKLL-së**

1. QKLL kryen detyrat e mëposhtme:

- a) nxjerr Urdhëra dhe Udhezime për përzgjedhjen e programeve dhe projekteve në fushën e librit dhe siguron financimin e tyre;
- b) promovon botimet e librit dhe revistave cilësore në fushën e letërsisë dhe shkencave shoqërore;
- c) krijon kushtet nxitëse për autorë cilësorë që veprojnë në fushën e letërsisë dhe shkencave shoqërore duke akorduar mbështetje financiare, si dhe dhënien e çmimeve kombëtare letrare;
- d) nxit dhe promovon librin dhe autorët shqiptarë;
- dh) realizon dhe promovon në forma të ndryshme bashkëpunimin ndërkombëtar në fushën e librit, kryesisht përkthimeve të autorëve shqiptarë në gjuhë të huaja, prezantimeve të letërsisë shqipe dhe shkencave shoqërore në nivel ndërkombëtar;
- e) krijon kushtet për zhvillimin e kulturës së leximit në të gjitha grupmoshat;
- ë) promovon zhvillimin e rrjetit libror në të gjithë territorin e vendit dhe krijon kushtet për një qasje të shtuar drejt politikave të librit;
- f) bashkëpunon me institucione ndërkombëtare që veprojnë në fushën e librave;
- g) monitoron dhe mbikëqyr zbatimin e programeve dhe projekteve të cilat financon;
- gj) bashkëpunon me organet shtetërore për planifikimin e politikave publike dhe akteve të tjera rregulluese në fushën e librit, si dhe me organizata të tjera që kanë në fokus të veprimtarisë së tyre zhvillimin dhe përhapjen e kulturës së librit;
- h) siguron fonde të jashtme dhe burime të tjera të financimit në fushën e librit në zbatim të këtij ligji;
- i) mban të dhënat që burojnë nga ky ligj dhe akte të tjera rregulluese në zbatim të këtij ligji;
- j) nxjerr akte administrative dhe realizon detyra të tjera me natyrë trajnuese dhe promovuese në përputhje me qëllimin e QKLL-së.

**Neni 11/3**  
**Drejtori i QKLL-së**

1. Drejtori i QKLL-së emërohet dhe lirohet nga detyra nga Ministri përgjegjës për librin, bazuar në procedurat dhe kriteret e përcaktuara nga Ministria përgjegjëse për librin.
2. Drejtori i QKLL-së ka mandat 4 vjeçar.

**Neni 11/4**  
**Miratimi dhe financimi i projekteve dhe veprimtarive në fushën e librit**

1. Miratimi i projekteve dhe veprimtarive në fushën e librit bëhet nga Drejtori i QKLL-së, me propozimin e Kolegjiumit, i cili përbëhet nga:
  - a) personalitete në fushën e letrave, të përcaktuara me urdhër të Drejtorit të QKLL;
  - b) nëpunës civilë të nivelit të lartë dhe të mesëm, drejtues të strukturave përgjegjëse, që mbulojnë fusha të caktura në fushën e librit dhe bibliotekave.
2. QKLL-ja, nëpërmjet buxhetit të saj të miratuar për çdo vit kalendarik, financon projekte të paraqitura nga persona fizike, juridikë, vendas ose të huaj, që kanë si objekt të veprimtarisë së tyre fushën e librit sipas këtij ligji.
3. Fondi, i përcaktuar në zbatim të këtij neni, nuk i nënshtrohet legjislacionit të prokurimit publik.
4. Kriteret dhe afatet në lidhje me projekt- propozimet për mbështetje financiare, të parashikuara në pikën 2 të këtij neni, përcaktohen me Urdhër të Drejtorit të QKLL-së.
5. Kolegjiumi i ngritur sipas përcaktimeve të këtij neni vlerëson dhe përzgjedh projektet nga pikëpamja e përmbajtjes dhe asaj financiare, duke i paraqitur Drejtorit propozimet për miratim.

**Neni 11/5**  
**Bazat e të dhënave**

1. Bazat e të dhënave, në kuptim të këtij ligji, mbahen dhe administrohen nga QKLL.
2. Në Statutin e QKLL-së përcaktohet forma dhe mënyra e administrimit si dhe elementet përbërës të bazës së të dhënave.

**Neni 11/6**  
**Të ardhurat e QKLL-së**

1. Të ardhurat e QKLL-së përbëhen nga:
  - a) fondet buxhetore shtetërore të akorduara sipas planit buxhetor për institucionet e varësisë nga Ministria përgjegjëse për librin;

b) të ardhura të siguruara nga qarkullimi dhe shitja e veprave në fushën e librit, krijuar me fonde buxhetore ose pjesërisht buxhetore;

c) të ardhura nga sponsorimet, donacionet;

d) të ardhura të tjera në përputhje me legjislacionin në fuqi;

Të ardhurat e llogaritura në përqindje parashikuar në gërmën “b” caktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

2. Të ardhurat e QKLL-së përdoren për të kryer detyrat e parashikuara në këtë ligj, për të siguruar kushte për financimin e aktiviteteve që organizohen dhe te shpenzimeve të tjera, të tilla si kostot e punës, kostot e materialeve dhe shërbimeve, kosto të tjera që lidhen me veprimtarinë e saj.

3. QKLL-ja mund të përcaktojë tarifa fikse për shërbimet që ajo ofron për individët dhe personat juridikë. Këto tarifa shërbimi miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

## **Neni 8**

Neni 12 shfuqizohet.

## **Neni 9**

Në pikën 5 të nenit 15 , pas fjalëve “...duke financuar” hiqen fjalët “nga Fondi Kombëtar i Librit...”.

## **Neni 10**

Në nenin 16 togfjalëshi “Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve...” zëvendësohet me togfjalëshin “Qendra Kombëtare e Librit dhe Leximit...”.

## **Neni 11**

Në nenin 17 në fund të pikës 1, shtohet një fjalia “Blerja e librit në kuptim të këtij neni nuk i nënshtrohet legjislacionit të prokurimit publik.”

## **Neni 12**

Pas nenit 18 shtohet neni 18/1 si më poshtë:

### **“Neni 18/1**

*Furnizimi i shërbimeve të shtypshkronjave dhe materialet e ofruara në formën tradicionale dhe cdo formë tjetër elektronike të librit, pavarësisht përmbajtjes së tij, që mund të lexohet nëpërmjet pajisjeve të tjera ndihmëse përfshirë edhe platformat elektronike (e-libri), përjashtohen nga tatimi mbi vlerën e shtuar.”.*

## **Neni 13**

Në nenin 19 bëhen shtesat dhe ndryshimet si më poshtë:

1. Në pikën 1, togfjalëshi “...*Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve...*” zëvendësohet me togfjalëshin “...*Qendra Kombëtare e Librit dhe Leximit, në përputhje me nenin 14, të këtij ligji...*”.

2. Në pikën 2, togfjalëshi “...*Ministrinë e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve...*” zëvendësohet me togfjalëshin “...*pranë Qendra Kombëtare e Librit dhe Leximit...*”.

#### **Neni 14**

Në nenin 21, pas gërmës “f” shtohet gërma “g” me përmbajtje si më poshtë:

“g) “...*tirazhi (numri i kopjeve)*...”.

#### **Neni 15**

Në nenin 28 pas fjalës “...*Agjencie...*” shtohet togfjalëshi “*përfaqësuar nga Titullari i Institucionit pranë së cilës ajo funksionon/Personi i autorizuar prej tij...*”.

#### **Neni 16**

Në nenin 29 hiqen fjalët “...ose me...”

#### **Neni 17**

Në nenin 41 pas fjalëve “...*në Bibliotekën Kombëtare*” shtohet fjalët “...*dhe në bibliotekat publike pranë njësive administrative vendore, ku ushtrojnë veprimtarinë.*”

#### **Neni 18**

Neni 42 ndryshohet si më poshtë:

#### **“Neni 42**

1. *Të gjithë botuesit, entet botuese dhe mjetet e informimit publik, shtetërore ose private, që ushtrojnë veprimtari në Republikën e Shqipërisë, detyrohen të dorëzojnë, pa shpërblim, në Bibliotekën Kombëtare, nga 5 (pesë) kopje për çdo botim. Për tekstet shkollore ata detyrohen të dorëzojnë 3 kopje (tre) kopje për çdo botim të parë dhe 2 (dy) për ribotimin, duke paguar edhe tarifën e shërbimit postar, kur është i nevojshëm”.*

2. *Të gjithë botuesit, entet botuese dhe mjetet e informimit publik, shtetërore ose private, që ushtrojnë veprimtari në Republikën e Shqipërisë, detyrohen të dorëzojnë, pa shpërblim në bibliotekat publike pranë njësive vendore, ku ushtrojnë veprimtarinë nga 3 (tre) ose 2 (dy) kopje për çdo botim duke paguar edhe tarifën e shërbimit postar, kur është i nevojshëm”.*

## **Neni 22**

Në nenin 48 bëhen ndryshimet e si më poshtë:

Në gjurmën d, të pikës 1, togfjaleshi “...nr. 9380, datë 28.4.2005 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të...” zëvendësohet me togfjaleshin “...nr. 35/2016, datë 31.03.2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to...”.

## **Neni 23**

Pas pikës 2 të nenin 49, shtohet pika 3 me përmbajtje si më poshtë:

“3. Në kuptim të nenit 18/1, të këtij ligji, përjashtimi nga tatimi mbi vlerën e shtuar për furnizimin e shërbimeve të shtypshkronjave dhe materialet e ofruara në formën tradicionale dhe cdo formë tjetër elektronike të librit, pavarësisht përmbajtjes së tij, që mund të lexohet nëpërmjet pajisjeve të tjera ndihmëse përfshirë edhe platformat elektronike (e-libri), do të zbatohet me hyrjen në fuqi të ndryshimeve të nevojshme në nenin 53, pika j, të ligjit nr. 92/2014 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe nenit 46, të Udhëzimit të Ministrisë të Financave me nr. 6, 30.01.2015 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë.”.

## **Neni 24**

Në të gjithë përmbajtjen e ligjit togfjalëshat “Ministri i Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve...” dhe “Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve” zëvendësohen me togfjalëshat “Ministri përgjegjës për librin” dhe “Ministria përgjegjëse për librin”.

## **Neni 25**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**

**ILIR META**